

PURGATORI

Vazhdojmë dhe e mbyllim rrugëtimin tonë rreth Gjërave të fundit të njeriut me temën e fundit që është Purgatori. Kemi thënë që sipas Kishës Katolike, gjërat e fundit të njeriut janë katër: vdekja, gjyqi, ferri dhe parajsa. Kemi folur për të katërta (shikoni shkrimet përkatëse për më tepër) dhe kështu që teorikisht e kemi mbyllur këtë çështje të gjërave të fundit. Atëhere pse po thua: vazhdojmë me temën e Purgatorit? Sepse, në një farë mënyre, edhe pse jo në mënyrë “zyrtare”, edhe Purgatori bën pjesë në gjërat e fundit të njeriut. Por, ngaqë, siç do të shikojmë, Purgatori nuk është një realitet përfundimtar siç janë Parajsa dhe ferri, por është një realitet kalimtar, do ta quanim ndryshe “korridori i Parajsës”. Pra, nuk kemi si të mos e trajtojmë temën e Purgatorit, që është një temë tepër e lidhur me atë të Parajsës, por edhe me secilin prej nesh, për disa arsye:



1. Kemi thënë, kur kemi folur për Parajsën, që për shumë arsye, është shumë e vështirë që të shkojmë menjëherë në Parajsë, sepse ata që janë në Parajsë gjenden jo vetëm në gjendje hiri, por e kanë veshjen e bardhë si bora, pra janë të pastruar tërësisht nga çdo lloj mëkati

2. Duke qenë Purgatori një vend përveçse lumturie të madhe, edhe i një vuajtjeje shumë të madhe, duhet ta dimë si për ne, si për ata të dashur tanë që mund të gjenden aty dhe që ne duhet t'i ndihmojmë, se si mund t'i ndihmojmë

Atëhere, le të fillojmë pa humbur kohë, duke e zhvilluar temën si përherë, në formën e pyetjeve:

1. A EKZISTON PURGATORI? NQS PO, SI E DIMË?

Edhe për Purgatorin vlen i njëjti arsyetim që kemi bërë për ferrin e për parajsën: duke qenë realitete shpirtërore, që janë jashtë dimensioneve të kohës dhe të vendit (pra jashtë botës sonë materiale në të cilën aktualisht gjendemi) nuk mund as t'i shikojmë me sytë

tanë, as t'i prekim dhe as të arrijmë në ekzistencën e tyre vetëm me arsyetimin tonë, nqs dikush që i ka parë dhe që i njeh mirë këto realitete nuk na i zbulon. Tani, Ai që njeh këto realitete është Zoti, pra është Jezu Krishti.

Këtu, ndryshe nga temat e ferrit dhe të parajsës, për të cilat jemi dakord me vëllezërit tanë protestantë, përsa i përket Purgatorit, ndryshon puna. Protestantët thonë që Purgatori nuk ekziston. Por cila është arsyeja që thonë këtë? Sepse, thonë ata, Jezusi nuk ka folur askund në Bibël për purgatorin (ndryshe nga ferri e parajsa, ku i kemi parë pjesët biblike të shumta në të cilat ai flet haptas për ta). Po, është e vërtetë që nuk ka folur për Purgatorin në Bibël... haptas! Dmth, nuk e ka quajtur me emrin që e quajmë tani “Purgator”, por në fakt ka shumë pjesë biblike, si të Dhjatës së Re, ashtu edhe të Vjetër, që na e zbulojnë dhe na e pohojnë ekzistencën e Purgatorit.

Para se t'i japim, duhet të kemi parasysh që nuk është mirë të fiksohemi pas emrave, por duhet të kuptojmë esencën dhe kuptimin që çdo emër mbart në vetvete. Atëhere, **Purgatori quhet i tillë, sepse vjen nga fjala latinisht "purgare" që do të thotë të pastrosh, të lirosh diçka nga të gjitha papastërtitë.** Pra, me pak fjalë, Purgatori është ai realitet pas vdekjes së njeriut, dmth pas shkëputjes së shpirtit të pavdekshëm nga trupi që vdes, në të cilin shpirti pastrohet, lirohet nga papastërtitë e tij, dmth "purgohet". Nga kjo, ja emri "Purgator". Por të mos fiksohemi tek fjala, e cila është vendosur kështu për këtë arsye, por tek kuptimi dhe tek ajo çka ndodh në këtë realitet. Atëhere, sikurse për Parajsën kemi thënë që kishte 30 emra të ndryshëm me të cilët quhej i njëjti realitet i Parajsës, kështu do të themi që në Bibël, edhe pse nuk është përdorur taman kjo fjalë purgator, por duke përdorur fjalë dhe shpjegime të ngjashme, është folur dhe demonstruar që purgatori ekziston realisht. Le t'i përmendim:

Prandaj po ju them: çdo faj e blasfemi do t'u falet njerëzve, kurse blasfemia kundër Shpirtit Shenjt, nuk do të falet. E nëse ndokush thotë ndonjë fjalë kundër Birit të njeriut, mund t'i falet faji, por nëse ndokush thotë ndonjë gjësend kundër Shpirtit Shenjt, nuk do t'i falet as në këtë botë as në botën e ardhshme." (Mateu 12, 31-32)

Tani këtu Jezusi po flet për disa lloj mëkatesh, cilat falen e cilat jo, e thotë që çdo lloj faji do t'i falet njeriut, por blasfemia kundër Shpirtit të Shenjtë jo. Nuk jemi këtu për të komentuar se çfarë është kjo blasfemi (shiko: Urdhëresa e parë), por ajo që na intereson tani për tani është që të dimë që Jezusi thotë që ka ca mëkate që nuk falen as në këtë botë, as në botën e ardhshme.

Deduktojmë që në botën e ardhshme, ka ca mëkate që falen e ca që nuk falen. E dimë që në Parajsë nuk mund të "falet", pra nuk mund të hyhet me asnjë lloj mëkati e papastërtie, kështu që e sigurtë që nuk po flet për Parajsën. Po ashtu, e dimë që në ferr nuk falet asnjë lloj mëkati, në kuptimin që në ferr nuk mund të kthehet mbrapsht askush: ai që shkon në ferr, atje mbetet përgjithmonë dhe nuk mund t'i falet asnjë lloj mëkati, kurrë. Atëhere, nuk po flet për Parajsën, nuk po flet për ferrin, kush është ky realitet tjetër i botës së ardhshme, në të cilin disa mëkate falen, por disa të tjera jo? Deduktojmë pra që Jezusi këtu po flet për Purgatorin, në të cilin disa mëkate nuk falen (mëkatet e rënda) dhe disa falen (mëkatet jo të rënda). Do të shikojmë më tej. Por, le të shikojmë një pjesë tjetër biblike ku flitet për purgatorin:


*Sipas hirit që Hyji ma ka dhënë, unë, porsi arkitekt i mirë, vura themelin, një tjetër vazhdon me mur mbi të; por secili t'ia vërë mendjen si ndërton. Sepse, askush nuk mund të vërë tjetër themel, përveç atij që është vënë, e ai është Jezu Krishti. Kushdo të ndërtojë mbi këtë themel me ar, me argjend, me gur të paçmueshëm, me dru, me sanë, me kashtë - vepra e secilit do të dalë në dritë. Ajo Ditë do ta tregojë, sepse do të vijë me zjarr, e zjarri do ta provojë cilësinë e veprës të secilit. Ai, vepra e të cilit do të qëndrojë, do të marrë shpërblimin. **Po iu dogj vepra ndokujt, ai do të pësojë dëm; me të vërtetë do të shëlbohet, por nëpërmjet zjarrit.** (I Korintasve 3, 10-15)*

Edhe në këtë letër të Shën Palit Purgatori nuk përmendet drejtpërdrejtë, por deduktohet (dhe nga kjo pjesë Kisha Katolike ka nxjerrë doktrinën e saj mbi Purgatorin) që ekziston një realitet i tillë. Shën Pali flet për shpërblimin që do të marrë secili sipas meritave, sipas jetës që ai ka bërë në këtë jetë, me pak fjalë për gjyqin (një nga gjërat e fundit të njeriut). Dhe thotë: ai, vepra e të cilit do të qëndrojë, do të marrë "shpërblimin"; e ka fjalën për të gjithë ata që shpëtojnë dhe veprat e tyre janë të mira e tërësisht të pastra ("do të marrin shpërblimin") ose jo plotësisht të pastra ("po ju dogj vepra ndokujt"). Atëhere, këta të fundit, nuk janë ata që ju digjet vepra (dmth jeta, shpirti, gjithçka çka kanë bërë në këtë jetë) përfundimisht e që nuk shpëtojnë (pra që shkojnë në ferr), por janë ca të tjerë, që as nuk digjen totalisht si ata të ferrit (se e thotë vetë: me të vërtetë do të shëlbohet), por as nuk janë ndër ata që marrin shpërblimin (e kemi thënë që një mënyrë tjetër për të quajtur parajsën

ishte fjala “shpërblim”). Kush janë këta që shpëtojnë, pra nuk shkojnë në ferr, por as nuk shkojnë akoma në parajsë? Këta, thotë Shën Pali “shëlbohen, por nëpërmjet zjarrit”. Ou, zjarri?! Mos, aman, zjarri ishte në ferr, është distinktiv i ferrit! Eh jo pra, ishte zjarri në ferr, por këtu patjetër flitet për një zjarr tjetër, se këta shëlbohen thotë Shën Pali. Pra, po flet për një realitet tjetër të botës së përtejme, që Kisha Katolike e ka quajtur “purgator”, në të cilën shpirtrat shpëtojnë, pra do të thotë nuk shkojnë në ferr, por as nuk shkojnë direkt në Parajsë, sepse përpara duhet të kalojnë këtë “zjarr”. Ça është? Do të shohim.

Së fundmi, në Dhjatën e Vjetër flitet haptas për Purgatorin:

“Juda pastaj mblodhi ushtrinë dhe arriti në qytetin e Odollamit, pasi plotësohej java, u pastruan sipas zakoneve dhe kaluan atje të shtunën. Ditën tjetër, kur tashmë ishte e nevojshme të bëhej, njerëzit e Judës shkuan që të mblidhnin kufomat e t’I vendosnin së bashku me të afërmit e tyre në varre familjare. Por gjetën poshtë tunikës të secilit të vdekur objekte të shenjta kundrejt idhujve të Iamnia, që ligji ua ndalon judenjve. Qe atëhere i qartë motivi për të cilin ata kishin vdekur. Kështu të gjithë, duke bekuar veprën e Zotit, gjyqtar I drejtë që I bën të dukshme gjërat e fshehta, ju drejtuan lutjes, duke u lutur që mëkati i bërë të falej plotësisht. Fisniku Juda i nixti të gjithë popullin që të ruhen pa mëkate, duke qenë se e kishin parë me sytë e tyre se Çfarë kishte ndodhur për shkak të mëkatit të të vdekurve. Pastaj, pasi bënë një mbledhje parash, ku secili linte dicka, përreth 200 drama argjendi, i dërgoi në Jeruzalem që të ofrohej sakrifica e ndreqjes, duke vepruar kështu në mënyrë të mirë e fisnike, i frymëzuar nga mendimi i ringjalljes. Sepse, nqs nuk do të kishte patur një besim të fortë që të vdekurit do të ringjallen, do të ishte e kotë dhe sipërfaqësore që të luteshin për ta. Por nqs ai e konsideronte shpërblimin e mrekullueshëm që u është rezervuar atyre që vdesin me ndjenja mëshire, kjo konsideratë ishte e shenjtë dhe devote. Prandaj ai caktoi që të ofronin sakrificën e ndreqjes për të vdekurit, që të mund të faleshin nga mëkati”. (Libri i dytë i Makabejve, 12, 38-45)



Pra Juda Makabei, ky njeri i drejtë dhe fisnik, edhe pse njerëzit që kishin vdekur kishin bërë mëkate të rënda (adhurim idhujsh, që sidomos për hebrenjtë ishte një mëkat shumë i rëndë), ka shpresë e besim në Zotin që mund të kenë shpëtuar (nga ferri) dhe që një ditë do të ringjallen. Por gjithsesi e di dhe e ndjen që mëkati i tyre, edhe pse mund të jetë falur e ata mund të kenë shpëtuar, prapë se prapë ka frikë se mos nuk është falur plotësisht, në kuptimin që mëkati u është falur, por duke qenë dëmet e këtij mëkati të rëndë shumë të mëdha, ata mund të mos jenë pastruar tërësisht. Atëhere, ai bën një mbledhje parash dhe i çon në tempullin e Jeruzalemit, aty ku ishte kulti qendror ndaj Hyjit, për ndreqjen e mëkatit të këtyre të vdekurve. Pra, nuk janë në ferr, nuk janë as në Parajsë, ku janë? Normalisht, në një realitet tjetër, që Kisha e quan Purgator.

Pra, PURGATORI EKZISTON. NE E DIMË QË EKZISTON SEPSE NA E KA THËNË VETË ZOTI, JEZU KRISHTI. EDHE PSE NUK KA FOLUR DREJTPËRDREJTË PËR TË,

NA KA BËRË TË KUPTOJMË QË SIGURISHT EKZISTON NJË REALITET QË NUK ËSHTË AS FERRI, AS PARAJSJA, KU SHKOJNË ATA QË SHPËTOJNË NGA FERRI, POR NUK JANË GATI PËR TË HYRË NË PARAJSË.

2. ÇFARË ËSHTË PURGATORI?

Folëm pak a shumë për Purgatorin. Por le të vëmë pikat mbi i.

Purgatori është një realitet i botës së përtejme, së ardhme, që është efekt i Mëshirës Hyjnore për të gjithë shpirtrat, që vdesin në gjendje hiri, por nuk janë të pastruar tërësisht prandaj nuk mund të futen menjëherë në Parajsë. Purgatori u lejon të gjithë këtyre shpirtrave që të pastrohen, të purifikohen, për të qenë të gatshëm për të shkuar në Parajsë. Është e pamundur që të futemi në Parajsë nqs ka edhe qoftë një papastëri krejtësisht të vogël.

Duke qenë se në këtë botë është tejet e vështirë që të purifikohemi plotësisht e të bëhemi të gatshëm për t'u futur në Parajsë menjëherë në çastin e vdekjes, sado që Zoti dhe Kisha na kanë dhënë pafundësisht "vegla shpëtimit dhe pastrimi", ne duhet të falenderojmë Zotin ditë e natë që e ka lejuar, falë Mëshirës së tij të pafund, ekzistencën e këtij realiteti. Përndryshe, për shumë prej nesh, do të ishte e pamundur të arrinim parajsën. Dua vetëm të kujtoj që Parajsja nuk është vetëm një gjendje perfeksioni, ntë cilin jemi plotësisht të lumtur e të kënaqur por është marrëdhënia intime me vetë Zotin dhe është objektivi i vetëm dhe më i madh i jetës sonë: është arsyeja për të cilin jemi krijuar dhe për të cilin jemi në këtë botë. Çdo gjë është fjalë boshe, nqs nuk e kemi të qartë objektivin tonë qendror, themelor.

3. KUSH SHKON NË PURGATOR?

Ata që vdesin në hir dhe në miqësi me Zotin, por janë të pastruar në mënyrë jo perfekte, edhe pse janë të sigurtë për shpëtimin e tyre, u nënshtrohen, pas vdekjes së tyre, një purifikimi, që të fitojnë shenjtërinë e duhur për të hyrë në lumturinë e qiellit (KKK 1030).

Ça na thotë Katekizmi?

Pra, shkon në Purgator ai shpirt njeriu që në çastin e vdekjes, pra kur shpirti i tij i pavdekshëm shkëputet nga trupi, gjendet në hirin shenjtëruës të Zotit, dmth nuk është në gjendje mëkati të rëndë, por ka akoma mëkate jo të rënda për të pastruar.

Prandaj, është tejet e rëndësishme që të dimë se cilat janë mëkatet e rënda, sepse siç po e shikojmë ekziston një humnerë midis mëkateve të rënda dhe atyre jo të rënda. Mëkatet e rënda, nqs nuk pendohe mi as në çastin e fundit të jetës për ta, na çojnë në ferr. Përkundrazi, mëkatet jo të rënda nuk na çojnë në ferr, por nqs nuk jemi penduar dhe pastruar mirë nga ata, na çojnë në purgator, sepse në Parajsë nuk mund të futet asgjë e papastër.

4. A ËSHTË E SIGURTË QË SHKOJMË NË PARAJSË PAS PURGATORIT?

Po, ai shpirt njeriu që gjendet në Purgator, pasi të përfundojë pastrimin e tij të plotë, dmth Purgatorin e tij, është e sigurtë dhe e garantuar që shkon në Parajsë. Në asnjë lloj mënyrë, kurrë, asnjë shpirt, pasi të përfundojë Purgatorin, nuk mund të shkojë në ferr. Kjo është në kundërshtim edhe me vetë fjalën purgator, sepse në ferr gjendet çdo lloj papastërtie e mundshme dhe ai që gjendet në purgator, gjendet aty pikërisht sepse po pastrohet, po purifikohet nga çdo papastërti.

Po ashtu, në asnjë mënyrë nuk mund të ndryshojë mendje ai njeri që gjendet në Purgator dhe psh të thotë jo gabova dua të shkoj në ferr, sepse në botën e përtejme nuk jemi më në kohë, por në amshim, dhe nuk ekziston një çast tjetër për t'u penduar. Normalisht, do të ishte absurde që një njeri të pendohej që do të shkojë në Parajsë, por ne po konsiderojmë edhe absurditetin.

Pra, Purgatori është një “korridor”, ku njeriu qëndron për pak a shumë kohë, derisa të kalojë në dhomën e ndjenjes, dmth në Parajsë, e aty të rrijë i qetë e i lumtur me Zotin e me anëtarët e parajsës përgjithmonë.

Siguria e shpëtimit, pra siguria dhe vetëdija e plotë e shpirtave të Purgatorit që sigurisht sapo të përfundojnë pastrimin do të shkojnë në Parajsë, përbën gëzimin dhe lumturinë më të madhe të këtyre shpirtave. Kjo lumturi është aq e madhe, sa nuk mund të krahasohet me asnjë lumturi, sado e madhe, e kësaj bote.

Këta shpirta quhen ndryshe shpirta të shenjtë, sepse pra janë “pak hapa” afër Parajsës. Këta shpirta gëzojnë gjithashtu vizitat e engjëjve dhe të shenjtërve (disa mistikë thonë që vetë Zoja Mari shkon e i viziton ata dhe u sjell shumë freski); e kanë të pamundur që të mëkatojnë më dhe kanë dashurinë e Zotit. Për të gjitha këta arsye, gëzimi i tyre është më i madh se të gjitha gëzimet e kësaj bote, sipas Shën Bernardinos së Sienës.

5. SI PASTROHEN SHPIRTRAT NË PURGATOR?

Por, në të njëjtën kohë, edhe pse pra janë më të lumtur se të gjitha lumturitë e kësaj bote, duke qenë se është një vend pastrimi dhe ndreqjeje të atyre mëkateve për të cilat nuk janë pastruar mirë, atëherë edhe vuajtjet e tyre janë të mëdha, përbiles janë më të mëdha se vuajtjet më të mëdha të kësaj bote, sipas Shenjtes Katerina e Genovës.

Shpirtat e Purgatorit pastrohen nga mëkatet jo të rënda për të cilat nuk janë penduar, ose nga mëkatet e rënda për të cilat janë penduar por jo pastruar tërësisht, nga dëmet që rrjedhin nga këto mëkate, nga lidhjet e çrregullta me gjërat e kësaj bote nëpërmjet zjarrit. Prapë ky zjarri?! Mos! A ishte në ferr, tani edhe në Purgator? Po, por zjarri i ferrit nuk ka të

bëjë fare me zjarrin e Purgatorit. Ose më mirë, zjarri i ferrit ishte si pasojë e ndëshkimit të shqisave (shiko: ferri) dhe ishte i përjetshëm; nëpërmjet tij shpirtat nuk purifikohen, por vetëm marrin atë ndëshkim të drejtë të mëkateve të bëra për të cilat nuk kanë dashur të pendohen as deri në çastin e fundit të jetës. Përkundrazi, zjarri i purgatorit quhet “zjarr pastrues”.

Pra, zjarri i purgatorit nuk është për të ndëshkuar, por për të pastruar shpirtat e purgatorit nga çdo papastërti, pak a shumë sikur pastrohet hekuri në zjarr nga ndryshku. Nuk dihet mirë nqs në këtë rast zjarri është i vërtetë si zjarri i ferrit, apo është një simbol që përdoret për të treguar thellësinë e



pastrimit që bëhet në Purgator. Disa teologë thonë që ky zjarr pastrues simbolizon vetë Zotin, i cili shëron e pastron shpirtrat.

Shenjta Katerina e Genovës thotë që nqs Zoti nuk do ta kishte krijuar Purgatorin, shpirtrat do ta kishin kërkuar vetë, sepse kur prezantohen në gjykatën e Zotit (shiko: Gjyqi) ato vetë nuk mund dhe nuk duan të rrinë përpara Zotit as me njollën më të vogël, prandaj do të hidheshin ata vetë, kokë e këmbë në Purgator, sepse shikojnë defektet e papastërtitë e tyre dhe shikojnë që nuk mund ta duan Zotin me gjithë zemër sikur ata vetë do të donin.

Dhimbja më e madhe e shpitrave të Purgatorit është dhimbja e atij që do me gjithë zemrën, me gjithë shpirtin por që nuk mund ta plotësojë dëshirën e vet për momentin. Është një dhimbje shumë e madhe! Për ne në këtë botë mund ta kuptojmë vetëm nqs e vëmë në analogji me ndonjë gjë të kësaj bote si puna, shtëpia, shkolla, nëna, babai, i fejuari, fëmija, martesja, dipllloma etj., pasi vështirë që ne në këtë botë të arrijmë ta kuptojmë dëshirën ekstreme, etjen që ata kanë për të parë Zotin në fytyrë, por kështu është: pamundësia për ta parë në sy e për ta shijuar plotësisht në Parajsë, përbën dhimbjen e tyre më të madhe, që i pastron dhe i bën të vuajnë në të njëjtën kohë.

Kujtoj vitet e para të universitetit, kur isha me provime në mes të verës, fundi i korrikut, i nxehtë i tmerrshëm përcëllues, koka që ziente pak nga nxehti, pak nga lodhja e sezonit të tejzgjatur që duke sikur nuk kishte fund kurrë: imagjinoni studentët e mjekësisë duke studiuar në fund të verës anatominë patologjike (ata që kanë studiuar mjekësi më kuptojnë menjëherë, aq më tepër nqs profesorët janë të tmerrshëm dhe më shumë se profesorë ngjajnë me Crudelia Demon!) dhe ndërkohë studentët e tjerë, ndoshta të disa fakulteteve jo kaq të rënda sa mjekësia (s'po e marr shembullin konkret këtu se mos po na i ngel hatri ndokujt) që dukej se e kishin mbaruar sezonin qëkur, përbiles nuk dimë as a ishin futur ndonjëherë në sezon! Por, ne jse, ajo që dua të them është që imagjinoni vuajtjen (dhe meqë në këtë jetë nuk jemi shpirtra aq të shenjtë sa në purgator, edhe zilinë) e ne studentëve të shkretë, tek na bien pikat e djersës nga balli në librin e anatomisë dhe tek na bëhet qullë pizhama që kemi të paktën nja... dy muaj që s'e kemi ndërruar, dhe gëzimin e këtyre të tjerëve, "fatlumëve" që jo vetëm kanë mbaruar sezonin, shkëlqyeshëm, me notat më të larta të mundshme, por tashmë edhe postojnë foto në Instagram, në Facebook, në plazhet më të bukura o të Shqipërisë, ose sikur të mos mjaftonte, të botës, duke pirë lëngje ekzotike, duke marrë ngjyrë nën diell e shumë gjëra të tjera të bukura e relaksuese. Ja, diçka të ngjashme vuajnë shpirtrat e Purgatorit, vetëm se shumëfishojeni për një milion!

Përtej shakave (ishte pak për t'u shfryrë edhe për vitet e vështira të universitetit, por diçka të ngjashme me purgatorin e kishte!), shpirtrat e Purgatorit vuajnë jashtëzakonisht shumë, edhe pse kanë ato gëzimet që përmendëm më sipër.

6. A MUND TË LUTEN SHPIRTRAT E PURGATORIT?

Atëhere, kjo pikë është shumë e rëndësishme.

Sipas teologut të madh Shën Tomës së Akuitit, Shpirtrat e Purgatorit, edhe pse janë superiorë ndaj nesh përse i përket shenjtërisë, janë inferiorë ndaj nesh për shkak të vuajtjeve që ata vuajnë. Për këtë arsye, ata gjenden në pamundësinë për t'u lutur për veten apo për dikë tjetër, por kanë nevojë për lutje.

Dmth, shpirtrat e Purgatorit gjenden në pamundësi për t'u lutur për veten apo për të tjerët. Imagjinoni një njeri, i cili po digjet në mes të sheshit (shembull pak si tragjik e di!) si psh. herën e fundit që dëgjova që një njeri i kishte dhënë flakë vetes përballë parlamentit. Çfarë bënë njerëzit? A ndenjën aty duke e parë “ah po digjet, ok punë për të!”, apo kthyen kokën e vazhduan secili punën e vet? Normalisht, kjo është diçka *alla Nard Ndoka*, dmth që dihet që instikti i secilit prej nesh, përveçse nqs jemi njerëz me zemër guri, është që të shkojë, t'i hedhë diçka, një batanije, ujë, ça të gjejë përpara, për ta ndihmuar, sepse është në flakë dhe nuk mund ta shuajë vetë flakën. Ja, diçka të tillë duhet ta imagjinojmë edhe për shpirtrat e Purgatorit. Nqs ne e dimë dhe e besojmë me të vërtetë këtë realitet, kujt do t'i shkonte nëpër mend që të mos i ndihmonte? Aq më tepër nqs mendojmë (dhe e thamë që është mjaft e mundur) që në atë “vend” gjenden edhe njerëz tanë të dashur, si njerëz të familjes, gjyshër, stërgjyshër, shokë, familjarë e të afërm apo të njohur të tjerë. Si mund të rrimë pa bërë gjë, pa i ndihmuar, nqs e dimë që me të vërtetë kanë nevojë për ne?! Ja, pra lind urgjenca për t'i ndihmuar dhe është një ndër veprat e mëshirës shpirtërore më të rëndësishme që të lutemi për të vdekurit (dmth kur thuhet lutemi për të vdekurit, supozohet që mund të jenë në purgator, sepse po qenë në Parajsë s'kanë nevojë për lutje sepse janë në rregull, po qenë në ferr po ashtu s'kanë nevojë për lutje sepse janë në gjendje të pakthyeshme dhe lutjet tona s'ju duhen).



Po ashtu, shpirtrat e Purgatorit me të vërtetë nuk mund të luten për ne drejtpërdrejtë (dmth siç bëjmë ne të gjallët, që lusim rruzaren për dikë) por mund t'i ofrojnë Zotit, sipas shumë teologëve, veprat dhe lutjet e tyre që kanë bërë kur kanë qenë në këtë tokë. Pra, nuk luten drejtpërdrejtë se thamë nuk mundën, jo se nuk do të donin, por luten prapë se prapë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë.

Atëhere, edhe për eksperiencën time shpirtërore personale: **LUTUNI PËR SHPIRTRAT E PURGATORIT**. Do të ndihmoni ata, dhe sa më shumë t'i ndihmoni, do të shikoni që aq më shumë do t'ju ndihmojnë ata juve. Gjithashtu, nqs ne, duke u lutur për shembull për shpirtin e një njeriu, psh të gjyshit tonë të ndjerë, ky i fundit arrin më në fund në Parajsë kryesisht falë lutjeve tona, e para kemi bërë një ndër veprat më të rëndësishme e më të bukura në botë (vijeni veten në vend të këtij gjyshit, kujt nuk do t'i pëlqente që, duke u gjendur në vuajtje të papara, në pamundësi totale për të ndihmuar vetveten, të ndihmon dikush e jo vetëm të ndihmon, por të çon në Parajsë, në lumturinë e pafund!) Kuptohet që ky gjysh do të na jetë përjetë mirënjohës dhe nuk do të reshtë kurrë së luturi për ne e njetet tona nga Parajsa.

Thuhet që Padre Pio, i cili është lutur shumë për shpirtrat e Purgatorit, kur është futur në Parajsë, është pritur përveçse nga shenjtërit e Parajsës, së pari nga të gjithë shpirtrat që ai ka çuar nga Purgatori në Parajsë, të cilët e nderonin dhe e falenderonin si të çmendur nga mallëngjimi e nga mirënjohja!

7. KU PASTROHEN SHPIRTRAT E PURGATORIT?

Kuptohet që përgjigja instiktive është “në Purgator”. Po, do të ishte e thjeshtë, nqs do të ishim të sigurtë që Purgatori është një vend. Por në fakt, nuk jemi të sigurtë. **Jemi të sigurtë që Purgatori është një gjendje e shpirtit**, i cili e përsërisim, edhe pse gjendet në hirin e Zotit, ka akoma papastërti për të cilat duhet të pastrohet.

Përsa i përket faktit që mund të jetë edhe vend, Kisha mban për mirë atë që thotë Shën Toma i Akuinit: **përsa i përket vendit të Purgatorit nuk ka asgjë të thënë haptas në Bibël e kështu që nuk mund ta zgjidhim këtë çështje.**

Po ashtu, e këtë po e themi për të gjithë ata që kanë frikëra të ndryshme, sidomos kur vdesin njerëz, si të afërm, si jo, kur gjenden trupat e tyre (sidomos natën kur njerëzit “i ruajnë” në pritje të varrimit) apo pas varrimit të tyre, sidomos në vendet ku ata kanë jetuar apo kryer aktivitete të ndryshme, si vepra të mira po edhe faje, mëkate, vrasje e gjëra të tilla, që tremben sepse dëgjojnë nga komshia apo nusja e axhës apo fqinji që vjen më shumë për të çarë kokën sesa për të dhënë ngushëllimet për të ndjerin, që “macja e shtëpisë ka ikur sepse ndjen prezencën e shpirtit që sillet vërdallë akoma nëpër shtëpi, sa të rehatohet”, apo gjëra të tilla (e kam dëgjuar me të vërtetë këtë teori, s’po e shpik unë) dhe ne duke qenë krejtësisht injorantë në këtë temë, i besojmë menjëherë se pastaj sado të konsiderohemi qenie inteligjente, racionale e si të duash, përpara vdekjes dhe këtyre fenomeneve të post-vdekjes jemi të gjithë të papërgatitur, të dobët, të mjerë, përveçse injorantë, më lejoni ta them. Epo, është mirë atëhere, përpara se t’i besojmë njeriut të parë që na del në rrugë e që na thotë teorinë e tij të marra nga nuk e di kush magjistar apo që ja ka pjellë mendja në atë çast, të paktën të dimë ç’a na thotë feja jonë, Kisha Katolike dhe shenjtërit e saj. Sigurisht, më lejoni të them me plot gojën, që shën Toma i Akuinit, doktor i Kishës, është shumë më i besueshëm se fqinja jonë!

Atëhere, le ta heqim nga mendja: fantazmat nuk ekzistojnë. Shpirti, pas vdekjes, pra pasi shpëputet nga trupi, shkon o në ferr, o në parajsë, ose në Purgator. Po e themi që purgatori nuk e dimë a është edhe vend, por sigurisht është gjendje e shpirtit, dhe gjithsesi janë realitete të botës së përtejme, pra nuk i përkasin më botës materiale, gjenden jashtë kohës dhe jashtë vendit, ashtu sikurse shpirti pas vdekjes. **Shpirti pas vdekjes nuk futet në një trup tjetër njeriu apo kafshe sikurse thonë hinduistët a budistët, nuk sillet vërdallë andej këndeje si lugat nëpër vendet që ka jetuar në këtë tokë siç mendojnë teorinë e ndryshme në të cilën age e gjëra të tilla, nuk ekzistojnë as fantazmat** as gjëra të tilla. Ju siguroj që më shumë se të kemi frikë nga të vdekurit, duhet të kemi frikë nga të gjallët, që janë sigurisht më të rrezikshëm (disa!) se sa të vdekurit. Aq më tepër nqs gjenden në Purgator apo në Parajsë (e urojmë për të gjithë ne e të dashurit tanë) jo vetëm që nuk duhet të kemi frikë nga ata, por siç po themi, duhet të lutemi për ta e t’i lusim ata që të ndërmjetësojnë për ne tek Zoti, sepse janë shpirta të shenjtë, edhe pse në Purgator.

Shën Toma thotë gjithashtu që, edhe pse disa thonë që shpirtat e Purgatorit pastrohen në vendet ku kanë fajet e tyre, kjo nuk duket shumë e pranueshme sepse një shpirt mund të purifikohet për më shumë mëkate njëkohësisht. Megjithatë, me një leje të veçantë të Zotit, për qëllime të mira si psh. për të mësuar e për të nxitur të gjallët që të kenë besim në gjërat që thotë Kisha, sidomos në lidhje me Purgatorin e me ndihmën ndaj shpirtave që aty gjenden, thuhet që disa janë purifikuar në vende të ndryshme në mënyrë që ndëshkimi i tyre, duke ju bërë i dukshëm të gjallëve, t’i nxiste këta të fundit që t’i ndihmonin ata me lutje e vepra të mira. Por, e përsëris, këto janë gjëra të veçanta e rrallëherë ndodhin, e kur ndodhin, janë vetëm me lejen e Zotit e për të mirën e të gjithëve, si të gjallë, si të vdekur. Kështu që, nqs ju ka ndodhur apo do t’ju ndodhë (t’ju them të drejtën dyshej fort, shumica janë fantazi të mendjes sonë të dobët, por nuk përjashtohet se s’duhet të jemi skeptik) diçka e tillë, të mos keni frikë, por të bëni këtë: t’i ndihmoni këta shpirta për të shkuar në parajsë.

Dua t’ju kujtoj këtu një ngjarje që i ka ndodhur Padre Pios (por po flasim për një njeri që kishte dhurata si leximi i zemrave dhe bilokacioni, pra nuk është se e themi sot e nesër do të na ndodhë edhe neve!) në lidhje me shpirtat e Purgatorit, që ai i kishte “fiksuar” dhe ato e kishin fiksim atë:


Një natë, kur konvikti i fretërve ku jetonte Padre Pio ishte krejt mbyllur, pas darkës, dëgjohej ca zëra që thoshin “Rroftë Padre Pio!” Frati përgjegjës dërgoi Fra Gerardin që të shihte se kush ishin: kur ai zbriti tek porta e hyrjes, shikoi që gjithçka ishte në rregull, porta e mbyllur me hekura

me kujdes siç e mbyllnin çdo natë e gjithçka në rregull. Megjithatë, të gjithë i kishin dëgjuar ata zëra dhe frati superior nuk gjente dot paqe. Ditën tjetër shkon tek Padre Pio dhe e pyet Padre Pion nëse i kishte dëgjuar edhe ai ata zëra që nuk dinin nga vinin. Atëhere, Padre Pio i përgjigjet, krejt me qetësi, si të ishte gjëja më normale në botë, që ata ishin zërat e disa ushtarëve të vdekur që kishin ardhur për ta falenderuar për lutjet e tij.

Dhe një episod tjetër:

Një darkë Padre Pio po pushonte në një dhomë, kur shikon një njeri me një mantel të zi që i shfaqet para syve. Padre Pio e pyeti burrin se kush ishte e nga vinte dhe ai i përgjigjet, “Jam Pietro di Mauro, kam vdekur pikërisht në këtë vend, i cili ka marrë flakë, më 18 shtator të vitit 1908, kur ky vend ishte një azil për të moshuarit. Zoti më ka lejuar që të vij tek ju për t’ju kërkuar që të ofroni Meshën e ditës së nesërme për mua; falë kësaj Meshe do të mund të hyj në Parajsë!

Atëhere Padre Pio ofron meshën për këtë njeri dhe flet me fretërit e tjerë të konviktit, të cilët për kuriozitet shkojnë tek arkivat e bashkisë së San Giovanni Rotondo dhe gjejnë në këtë arkiv të shkruar pikërisht: Në datën 18 shtator 1908, në zjarrin e hotelit të pleqve, vdiq Pietro di Mauro”!



8. SI DUHET TË LUTEMI PËR SHPIRTRAT E PURGATORIT?

Atëhere, nga ato që thamë më sipër, besoj se kemi kuptuar që lind nevoja që të lutemi për shpirtrat e Purgatorit në çdo lloj mënyre, me çdo lloj lutjeje që kemi të disponueshme nga Nëna jonë Kisha Katolike për t’i liruar sado pak nga vuajtjet e jashtëzakonshme që ato vuajnë në Purgator. Ne e kemi këtë pushtet dhe duhet ta bëjmë! Po ashtu, duke qenë se kemi thënë, ose më mirë ka thënë Shenjtja Tereza, edhe ajo doktor i Kishës dmth nuk besoj se flet kot, që në një vizion kishte vënë re që vetëm 3 nga të gjithë njerëzit që kishin vdekur në një ditë kishin shkuar direkt në Parajsë, e duke llogaritur që çdo ditë vdesin rreth 15.000 njerëz, le të bëjmë një llogaritje të shkurtër (po përdor makinën llogaritëse se s’jam fort e zoja në matematikë), njerëzit, përfshi këtu njerëzit tanë të dashur dhe vetë ne kur të na vijë koha, kemi 0, 02% mundësi për t’u futur në Parajsë. Tani, e dimë që matematika e Zotit është ndryshe nga e jona dhe me Zotin 1 plus 1 zor se bën 2 (në kuptimin shpirtëror të fjalës), por e bëra këtë llogaritje të lezetshme thjesht për të treguar se **sa e vështirë, pothuaj e pamundur është që të mos kalojmë nga Purgatori!** Atëhere, duke qenë se të dashurit tanë, paraardhësit tanë dhe me shumë mundësi edhe ne një ditë, do të gjendemi në Purgator, le të angazhohemi seriozisht për këta shpirtra. Është një ndër veprat e mëshirës shpirtërore që të lutemi për të vdekurit dhe që të mendojmë për ta, është diçka që i pëlqen shumë Zotit Jezus dhe që na jep edhe vetë neve hire të pafundme.

Dua gjithashtu të specifikoj që nuk është mirë që të mjaftohemi me një “Jepua Zot pushimin e pasosur...” si lutje për të vdekurit, edhe pse patjetër si fillim është shumë i mirë dhe si vazhdim... por nuk mjafton kaq. Nëse gjyshi juaj o imi (se dikush mund të më thotë flit për veten), gjendet në Purgator dukë larë fajet e tij, vështirë që ta nxjerrim nga Purgatori me një ose

disa “jepua Zot Pushimin e pasosur”, sidomos nqs ka shumë për t’u pastruar. Dhe dua të specifikoj po ashtu që nuk është mirë të themi “oh po gjyshi im ka qenë njeri i mirë s’i ka ba keq as një mize” dhe kështu të reduktojmë lutjen për të, duke i futur në kokë vetes sonë që ai gjendet në Parajsë, ose mund të shkojë menjëherë sapo të bëj një apo tri lutje për të. Nuk dua që të shkurajohemi, por duhet të kemi kujdes: askush nuk e di se ku gjenden shpirtrat, përveçse Zoti, dhe askush nuk e di se çfarë mëkatesh e fajesh mund të kenë bërë, ndoshta edhe të brendshme, ta padukshme nga jashtë, për të cilat u duhet shumë shumë shumë kohë për t’i larë në Purgator. Duhet të kemi parasysh që Shpirtrat mund të qëndrojnë në Purgator edhe shekuj të tërë: ka shpirtra që gjenden në Purgator që nga fillimi i botës, ose që nga koha e Perandorisë Romake! Po ashtu, koha në Purgator nuk është sikur këtu, aty ekziston ajo që teologët e quajnë “*evo*”, prandaj 10 minuta në Purgator mund të jenë sikurse 1 vit në këtë tokë!

Atëhere, cilat janë lutjet kryesore dhe ndihmat kryesore që mund t’u japim këtyre shpirtrave, për t’i lehtësuar pjesërisht ose tërësisht vuajtjet e tyre në Purgator e për t’i ndihmuar që të arrijnë sa më shpejt lumturinë e amshuar, Parajsën?

1. Mesha e shenjtë

Ndihma e parë dhe më e madhe që mund t’u japim shpirtrave të Purgatorit është që të ofrojmë Meshën e shenjtë për ta. Sa? Një? Dy? Sa më shumë të kemi mundësi, aq më mirë është. Unë ju sugjeroj, sikurse edhe vetë Kisha, që të ofrojmë, të paktën për një shpirt të një vdekuri tanë të dashur, të ashtuquajturat Meshat gregoriane. Ça janë? Janë 30 mesha rresht që thuhet për shpirtin e të njëjtit person, pa ndërprerje. Nqs doni të ndihmoni një shpirt të Purgatorit, nuk ka mënyrë më të mirë, më të fortë se sa kjo. E përsëris: mënyra më e mirë për të ndihmuar një shpirt të Purgatorit është kjo, dhe ajo pak më e sigurta që mund të shkojë në Parajsë në fund të këtyre meshave... me shumë mundësi (sepse nuk është e sigurtë, mund të ketë akoma për të purifikuar); por nqs nuk mjaftojnë 30 mesha rresht për ta çuar në Parajsë një shpirt, a do të mjaftojnë sipas jush dhjetë rruzare? Nuk e di, sepse ju thashë që Zoti nuk është matematikan i mirë e s’duhet t’i llogarisim gjërat me makinë llogaritëse, por unë jua rekomandoj fort, shumë shumë fort që t’i bëni, sidomos për ndonjë të vdekur të afërm apo që e ndjeni që ka nevojë. Për eksperiencë personale, ju garantoj që do t’jua shpërblejë pafundësisht, shumë më shumë se sa të kishit bërë 30 mesha për veten tuaj!

Duke qenë se jo të gjithë kanë para fatkeqësisht për t’i bërë (sepse e dimë që Meshat kanë një ofertë të caktuar dhe kështu që në këtë rast oferta shumëzohet për 30), edhe pse duhet t’ju them që ka priftërinj, nqs arrini t’i gjeni, që jua bëjnë edhe për një ofertë më të vogël ose më të lirë, mundet gjithsesi të bëni ndonjë meshë, në sasi sipas mundësisë suaj, për shpirtrat e Purgatorit. Edhe sakrificat e parave është një tjetër gjë që shpërblehet shumë nga shpirti për të cilin i ofroni dhe ka shumë vlerë para syve të Zotit, sidomos nqs e bërë me sinqeritet e me zemër.

Ju sugjeroj fort që të merrni praktikën, zakonin, që të ofroni mesha vazhdimisht, sado që të keni mundësinë dhe dëshirën, që të bëni mesha për shpirtrat e të vdekurve, pra për shpirtrat e purgatorit. Është një nga devocionet më të mira që mund të ketë Kisha Katolike! Po ashtu, më lejoni të them pa më gjuajtur domate (edhe pse jemi online kështu që shqyr se keni mundësinë) nuk besoj se bëhet nami nqs sakrifikoni diçka nga vetja juaj, nga paratë tuaja, nga llogaritë tuaja, për të bërë ndonjë meshë për këta shpirtra. Ndoshta do jeni e do jemi (se flas gjithnjë për eksperiencë personale) pak më të varfër se përpara, por ju garantoj që do jemi shumë por shumë më të pasur jo vetëm nga brenda pra shpirtërisht, por edhe materialisht se do jua kthejnë njëqindfishin.


2. Indulgjencat

Ndoshta tema që prekëm më sipër është pak delikate, sidomos kur kemi të bëjmë me paratë duhet të jemi të kujdesshëm sepse është shumë mirë që të bëjmë atë që thamë më sipër, por nuk mund të detyrojmë askënd që të nxjerrë para nga portofoli për këtë çështje, sidomos kur... portofoli është bosh ose pothuaj bosh. Atëhere, përtej shakave, kemi mundësinë tjetër shumë të mirë për të ndihmuar të dashurit tanë të vdekur dhe shpirtrat e Purgatorit në përgjithësi, që janë indulgjencat. Këta, ndryshe nga meshat, janë krejtësisht falas! Por... si gjithnjë, duke qenë se dardha e ka bishtin prapa, mund të themi të njëjtën gjë për indulgjencat, jo që e kanë bishtin mbrapa në kuptimin që kanë ndonjë gjë të keqe, por që kanë diçka që mund të na kushtojë... Besoj se fjalën indulgjenca e kemi dëgjuar (edhe në librat e historisë në shkollë flitej për to) sidomos në lidhje me skandalin që lindi në lidhje me shitjen e indulgjencave! Duhet të kemi parasysh që terminologjia “shitja e indulgjencave” nuk është e saktë, sepse nuk kishte të bënte pikërisht me këtë (shiko për më tepër: Urdhëresa e parë/simonia) por sigurisht dua të nënvizoj që indulgjencat jepen krejtësisht falas dhe nuk kemi nevojë e as duhet të mendojmë kurrë që mund të paguajmë për t’i marrë, sepse përndryshe do të kishim të bënim me tregtimin “e të mirave shpirtërore të nevojshme për shpëtimin dhe hyrjen në Parajsë”. E sqaruar kjo pikë, le të themi se ç’a janë indulgjencat.

Ça janë indulgjencat?

Kur një individ mëkaton, sidomos në rastin e mëkatit të rëndë, por jo vetëm, mëkati që ai bën mbart në vetvete disa dëme dhe të këqija të cilat duhet të ndreqen, nga të cilat duhet të purifikohet. Atëhere, nqs një individ bën një mëkat, pendohet sinqerisht për këtë mëkat dhe rrëfëhet në këtë jetë, prapë se prapë ky mëkat, edhe pse me të vërtetë i falur nga Zoti, ka nevojë të bëjë atë që ne e kemi quajtur “pendesë” për të ndrequr dëmet që rrjedhin nga dhe që mëkati mbart në vetvete dhe për t’u purifikuar nga këto të këqija që vijnë nga mëkati.

Nqs pendesa nuk bëhet, për arsye të ndryshme, ose bëhet por nuk është e mjaftueshme, ky purifikim vazhdon në Purgator (gjithnjë nqs shpirti vazhdon të jetë në gjendje hiri deri në çastin e vdekjes). Ky purifikim është real dhe siç kemi thënë, i shkakton shumë vuajtje shpirtit që pastrohet, përveçse mbi bazën e sa duhet të purifikohet shpirti, mund të jetë edhe shumë i gjatë.



Atëhere, Kisha, si një Nënë e mirë, ka caktuar indulgjencat, që janë heqja (falja) e dënimit të përkohshëm që vjen nga mëkatet, tashmë të falura përsa i përket fajit.

Për kë mund të ofrohet indulgjenca?

Kuptohet që falja nga dënimi i përkohshëm që vjen nga mëkatet që janë të falura përsa i përket fajit me anë të rrëfimit, mund të merret që në këtë jetë ose në Purgator. Por, në këtë jetë ne nuk mund ta ofrojmë indulgjencën për një të gjallë tjetër, por vetëm për veten tonë (kjo sepse ai i gjalli tjetër është akoma në kohë, prandaj mund të pendohet, rrëfëhet dhe ta marrë ai vetë indulgjencën për veten e vet, pasi të ketë plotësuar kushtet). Përkundrazi, nqs

një shpirt është në Purgator, nuk mund të marrë asnjë indulgjencë për veten e vet (për parimin që thamë që në Purgator shpirtat nuk mund të luten për veten, dmth as nuk mund të ofrojnë indulgjencat për veten e vet) por vetëm një njeri që është në këtë tokë mund të ofrojë indulgjencën për to.

Pra, shkurt, **ne mund t'i marrim indulgjencat për veten tonë (dmth për faljen e dënimit që vjen nga mëkatet tona që i kemi rrëfyer) ose për një ose disa shpirta të vdekurish, që gjenden në Purgator** normalisht (se në Parajsë e në ferr s'kanë ça u duhen indulgjencat, e kemi thënë më sipër).

Pse Kisha mund të përcaktojë këto indulgjenca?

Kisha e ka fuqinë që ja ka dhënë Jezu Krishti për të zgjidhur e për të lidhur: “*Ty do të jap çelësat e mbretërisë së qiellit dhe gjithçka që do të lidhësh në tokë do të lidhet në qiell, e gjithçka që do të zgjidhet në tokë do të zgjidhet në qiell*”. (Mateu 16:19)

Kjo është fjalia që Jezusi i ka thënë Pjetrit, i cili është koka e Kishës së dukshme, pra vikari i Jezusit në tokë dhe Papa i parë siç e dimë. Kuptohet që, duke ja dhënë Shën Pjetrit këtë pushtet, po ja jep Papës, çdo Ati të shenjtë. Po ashtu, s'ka patur nevojë të thotë “po të jap pushtetin për të caktuar indulgjencat...” sepse në këtë fjali me fjalë simbolike, kuptohet që po i jep pushtetin për të zgjidhur, pra për të falur shumë gjëra, si mëkatet nëpërmjet rrëfimit (gjë që e thotë edhe në një kontekst tjetër më specifikisht) dhe nqs mund të falin mëkatet në emër të Jezusit, kuptohet që mund edhe japin mundësinë për të falur dënimin që vjen nga këto mëkate. Pra, shkurt, **Kisha Katolike e ka këtë pushtet që buron nga Mëshira e Hyjit dhe duhet ta ushtrojë për të mirën e shpirtave.** Po ashtu, këtë gjë **Kisha mund ta bëjë falë realitetit të Korpit Mistik të Krishtit (Kisha është ky Korp Mistik) dhe falë realitetit të bashkësisë së shenjtërve**, sipas të cilit të gjithë shenjtërit vënë në bashkësi meritat e tyre për të mirën e të gjithë shpirtave dhe besimtarëve. Sidoqoftë, meritat e çdo lloj shenjtëri sado të mëdha që jenë, e kanë burimin e tyre të gjitha në meritat e Zotit tonë Jezu Krishti, që është edhe Koka e Korpit Mistik.

Në shekullin tonë, çdo gjë që ka të bëjë me indulgjencat është përcaktuar në Kushtetutën Apostolike “Indulgentiarum Doctrina” nga Papa Paolo VI më 1 janar të vitit 1967 dhe në “Enchiridion Indulgentiarum” e Penitencierisë Apostolike (dua të them shkurt, që gjithçka që po them, por e them duke e marrë nga këto dokumente zyrtare).

Sa nga dënimi i përkohshëm mund të falë indulgjenca?

Përgjigja është: varet. Në linjë teorike, duhet të themi që **ekzistojnë dy lloj indulgjencash (faljesh): e plotë (plenariae) ose e pjesshme (partiales).**

Falja e pjesshme na jep faljen e pjesshme (pra vetëm të një pjese të dënimit të përkohshëm që vjen nga mëkatet e falura nga rrëfimi). Sa “përqind” i dënimit na falet? Nuk e dimë, e di vetëm Zoti. Sigurisht një falje të pjesshme e jep, se sa, nuk e dimë. Përpara Kisha e përcaktonte edhe “sasinë” e kohës, psh. thoshte “falje e pjesshme prej 300 ditësh” etj. Tashmë, me riformën e Papës Paolo VI, nuk thuhet më se sa, por thuhet thjesht “e pjesshme”.

Falja e plotë na jep faljen e plotë të dënimit të përkohshëm që vjen nga mëkatet e falura nga rrëfimi (përsa i përket fajit). Kjo do të thotë që, nqs ne sot, duke plotësuar të

gjitha kushtet (shiko më poshtë) për të marrë faljen e plotë, e ofrojmë faljen për veten tonë (pra për të na u falur nga Zoti dënimi i përkohshëm që ne kemi për shkak të mëkateve që kemi bërë dhe që kemi rrëfyer tashmë), na falet i gjithë dënimi. Dmth, përsa i përket dënimit, kemi 0 dënim. Kjo do të thotë që, nqs nuk mëkatojmë më në asnjë lloj forme (as me mëkatin më të vogël) dhe vazhdojmë kështu deri në çastin e fundit të jetës, pasi të vdesim shkojmë direkt në Parajsë! Oh, sa bukur... por fatkeqësisht utopike (kush mund t'i thotë vetes që nuk do të mëkatoj më as me më të voglin mëkat?!).

Po ashtu, kjo do të thotë që, nqs ne sot, pasi kemi plotësuar të gjitha kushtet për marrë faljen e plotë, e ofrojmë këtë falje të plotë për një shpirt x të vdekuri (që ne mendojmë që mund të jetë në Purgator dmth), atëhere atij shpirt njeriu menjëherë i falet i gjithë dënimi që po shlyen në Purgator (ndoshta edhe prej shumë shumë kohësh) dhe shkon direkt e në Parajsë, falë... faljes që ne ofruam për të! Është diçka e madhe, shumë e madhe siç e shikoni... nqs nuk do të ishte edhe kjo pothuaj utopike, fatkeqësisht! Po pse?

Sepse është e vërtetë që falja është e plotë dhe këtë nuk e vëmë në dyshim, por problemi është që për të marrë faljen e plotë ka disa kritere që duhet të plotësohen nga ne.

Cilat janë kriteret që duhet të plotësojmë për të marrë faljen (indulgjencën) e plotë?

Këto kritere janë:

- a. Kungimi sakramental në atë ditë që merret indulgenca
- b. Rrëfimi 8 /15 ditë para ose pas kësaj dite që merret indulgenca
- c. Lutja sipas njetit të Atit të Shenjtë (zakonisht 1 Ati ynë, 1 Të Falemi Mari, 1 Lavdi Atit)
- d. Vepra e indulgenciuar
- e. Shkëputje e plotë nga lidhja me çdo lloj mëkati, qoftë edhe më i vogli

Këto janë kriteret që duhet të plotësohen për të marrë faljen e plotë të dënimit të përkohshëm. Duhet të plotësohen të gjitha së bashku. Kuptohet atëhere pse thamë që falja e plotë është shumë e vështirë për t'u marrë me një indulgjencë të vetme: sepse pika e fundit është "speci djegës" për secilin prej nesh, pra shkëputja nga çdo lloj mëkati, edhe më i vogli. Zakonisht, pothuaj asnjë nga ne nuk është aq "shenjt" sa për të qenë tërësisht i shkëputur nga çdo lloj mëkati, sepse edhe në Bibël thuhet që edhe "i drejti mëkaton 7 herë në ditë (flitet për mëkatet jo të rënda)".

Atëhere për çka shërben kjo lloj indulgjence, nqs nuk mund ta plotësojmë asnjëri prej nesh? Shërben shumë, si për ne, si për ata shpirta të Purgatorit për të cilat duam ta ofrojmë. E para, kuptimi më i thellë i kësaj indulgjence është që të përparojmë sa më shumë në rrugëtimin e krishterë, duke ju larguar sa më shumë mëkatit (sa më shumë kjo të ndodhë, pra sa më të shenjtë të jemi, aq më afër "së plotës" do të jetë indulgenca). E dyta, edhe pse nuk është e plotë indulgenca (jo për faj të Kishës, por vetëm për fajin tonë që e kemi të vështirë të plotësojmë pikën e fundit), do të jetë e pjesshme dhe sigurisht do t'i ndihmojmë shumë shpirtat e Purgatorit.

Këshillë: *Mos u mjaftoni pra vetëm me një apo dy indulgenca (falje) të plota, por për arsyet që thamë më sipër, merrni sa më shumë indulgenca, sa herë ta keni të mundur, duke i ofruar o për veten, o për shpirtat e Purgatorit, duke shpresuar që nga njëra anë të kemi shtysën për t'ju larguar sa më shumë mëkatit, nga ana tjetër të na/të ju falet sa më shumë nga dënimi i përkohshëm që vjen nga mëkatet e falura përsa i përket fajit.*

Po ashtu, thamë që përveç Kungimit, Rrëfimit, lutjes sipas njetit të Papës e shkëputjes nga mëkatet, për të cilat besoj se s'ka nevojë për shpjegim më të thellë, duhet të kryejmë edhe të ashtuquajturën “vepër të indulgjencuar”. Ça është kjo?

E para, në disa ditë të veçanta, që i cakton Kisha, për të gjithë ose për anëtarë në bashkësi, vëllazëri, komunitete të ndryshme siç mund të jenë psh. anëtarët e Vëllazërisë së Rruzares që gëzojnë induljenca të plota të shumta në ditë të veçanta për Vëllazërinë (shiko: Pyetje mbi Vëllazërinë) nuk ka nevojë për të kryer veprën e indulgjencuar, por mjafton të kryejmë vetëm 4 kriteret e tjera.

Por, induljenca e plotë nuk merret vetëm në këto ditë, por mund të merret edhe përditë (gjithsesi maksimumi një herë në ditë, jo më shumë), nqs ne arrijmë të plotësojmë përditë 5 kriteret e sipërpërmendura, pra kungimi (psh. flitet për ato që shkojnë në meshë përditë, ose në përgjithësi edhe gjatë javës, jo vetëm të dielën), rrëfimi (që mund të jetë bërë edhe para 15 ditësh nga marrja e Kungimit, pra duke u rrëfyer një herë në 15 ditë, mund të marrim indulgjencën përditë, dmth me një rrëfim mund të merren më shumë induljenca, kurse me një kungim vetëm një indulgjencë), lutja sipas njetit të Atit të Shenjtë, shkëputja nga çdo lloj mëkati dhe vepra e indulgjencuar. Me një vepër të indulgjencuar mund të merret vetëm një indulgjencë e plotë.

Disa nga veprat e indulgjencuara janë:

- ❖ Adhurimi eukaristik për të paktën 30 minuta
- ❖ Lutja e Rruzares në kishë, në familje ose në komunitet
- ❖ Udha e Kryqit
- ❖ Leximi i Shkrimit të Shenjtë për të paktën 30 minuta
- ❖ Vizita e një kishe nga 1 nëntori në mesditë deri më 2 nëntor në mesnatë për të vdekurit
- ❖ Vizita e varrezave në një nga këto ditë: nga 1 nëntori deri më 8 nëntor (përfshi data 1 dhe 8), vetëm për të vdekurit
- ❖ Pjesëmarrja në një ceremoni solemne të Kungimit të parë të një personi ose të Meshës së parë të një prifti ose të 25/ 50/ 60 përvjetorit të shugurimit priftëror të një prifti
- ❖ Rinovimi i premtimeve të Pagëzimit gjatë vigjiljes së Pashkëve
- ❖ Adhurimi i Kryqit gjatë ceremonisë solemne në të premtën e Madhe
- ❖ Bekimi i Papës i marrë edhe duke e dëgjuar në radio ose në televizor
- ❖ Në çastin e vdekjes, mund të jepet nga një prift, ose duke puthur Kryqin (por personi që po vdes duhet të ketë thënë ndonjë lutje gjatë jetës).

Siç e shikojmë, veprat që mund të kryhen për të marrë indulgjencën janë të shumta dhe jo dhe aq të vështira për t'u kryer. Në mënyrë të veçantë nënvizoj faktin që nqs një njeri, rrëfëhet pak a shumë 1 herë në 15 ditë, shkon në Kishë, thotë rruzaren në Kishë (vetëm ose me ato njerëz që zakonisht e thonë 30 minuta para Meshës), thotë lutjen sipas njetit të Atit të Shenjtë (zakonisht 1 Ati ynë, 1 të Falemi Mari, 1 Lavdi Atit) dhe merr pjesë në Meshë duke marrë Kungimin, mund të marrë faljen e plotë (e plotë i thënçin, sepse e thamë që duhet të jemi të shkëputur nga çdo lloj mëkati e te kjo pikë të gjithë biem) për veten e vet, ose për ndonjë të dashur të vdekur apo për shpirtrat e Purgatorit në përgjithësi.

Ndoshta disa nga ju që shkojnë në Meshë i kanë bërë më shumë se një herë këto gjëra, por ndoshta pak prej jush e keni ditur se çfarë jeni duke bërë me taman, apo pak u ka shkuar mendja të ndihmojnë shpirtrat e Purgatorit. Shpresojmë që sot t'i kemi kuptuar më thellësisht.

3. Lutje të ndryshme dhe vepra të mira

Ka edhe shumë lutje të tjera që mund të ofrojmë për shpirtrat e Purgatorit, si psh. Rruzarja, Kurora e Mëshirës Hyjnore, Kurora e 100 “Jepua o Zot pushimin e pasosur” e lutje të tjera: të gjitha i ndihmojnë shumë shpirtrat e Purgatorit. Po ashtu, çdo vepër e mirë, sakrificë, vuajtje, agjërime etj e ofruar për ta, i ndihmon shumë këto shpirtra.

Ky pra ishte Purgatori! Shpresoj të kemi thënë disa nga gjërat kryesore, pasi gjërat për të thënë në lidhje me këtë temë janë të shumta e nuk mbarojnë kurrë. Kështu e kemi mbyllur edhe ciklin e “Gjërat e fundit të njeriut” dhe jemi gati për të filluar ciklin tjetër, shumë të rëndësishëm, atë të dhjetë urdhëresave. Faleminderit!

